



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA DURRESE
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 44, datë 29.05.2020

PËR

MIRATIMIN PËR DHËNIEN ME QIRA TË TERRENIT SPORTIV, QË PËRFAQËSON DY FUSHA TENISI ME SIPËRFAQE 1420 M²; TË AMBJENTIT GODINË 1 KAT ME SIP. 32.4 M² DHE TË SIP.124.6 M², QË PËRSHIN SHKALLËT BETONARME DHE NDËRTIME TË RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS (KANALIZIME DHE SIP. TË GJELBËRUARA), QË JANË NË FUNKSION TË TERRENIT SPORTIV, ME VENDNDODHJE NË TERRITORIN E GJIMNAZIT "LEONIK TOMEU", PRONË E BASHKISË DURRESE, PËR NJË AFAT 5 (PESË) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës", i ndryshuar, Ligjit Nr.79/2017 "Për sportin", Ligjit Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Për Qiranë", shkresës nr. 563/1, datë 28.05.2018, ardhur nga Gjimnazi "Leonik Tomeu", sipas Relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ligjore, AKRSKF dhe Burimeve Njerëzore në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin për dhënie me qira të terrenit sportiv, që përfaqëson dy fusha tenisi me sipërfaqe 1420 m²; të ambjentit godinë 1 kat me sipërfaqe 32.4 m² dhe të sipërfaqes 124.6 m², që



përfshin shkallët betonarme dhe ndërtime të rrjetit të infrastrukturës (kanalizime dhe sipërfaqe të gjelbëruara), që janë në funksion të terrenit sportiv, me vendndodhje në territorin e gjimnazit “Leonik Tomeo”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat 5 (pesë) vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Ligjore, Sektori i Pronave Publike Dhe Menaxhimit Të Aseteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.05.2020




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 488/prot.
4

Durrës, më 03.06.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.44 datë 29.05.2020 Për miratimin për dhënie me qira të terrenit sportiv, që përfaqëson dy fusha tenisi me sipërfaqe 1420 m²; të ambientit godinë 1 kat me sip. 32.4 m² dhe të sip.124.6 m², që përshin shkallët betonarme dhe ndërtime të rrjetit të infrastrukturës (kanalizime dhe sip. të gjelbëruara), që janë në funksion të terrenit sportiv, me vendndodhje në territorin e gjimnazit “Leonik Tomeo”, pronë e bashkisë Durrës, për një afat 5 (pesë) vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

